



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 112 Prot.

Gjirokastrë, më 22 . 01 . 2026

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA



Lënda: Hapen thirrjet për shërbim projekt propozimesh në kuadër të programeve të financimit për vitin 2026 në Shqipëri nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka hapur thirrje të reja për projekt propozime, si vijon:

Nr.	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Thirrje për aplikim për projekte të infrastrukturës së kërkimit shkencor (PIKSH)	27.02.2026
2	Thirrje për Projekt - Propozime në Kuadër të Programeve Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI)	27.02.2026

1. Thirrje për aplikim për projekte të infrastrukturës së kërkimit shkencor (PIKSH)

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, shpall thirrjen për aplikim për "Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" për vitin 2026", me synim mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturave kërkimore moderne në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare dhe europiane.

Qëllimi i thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrjeje është forcimi dhe modernizimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare dhe europiane, me synim rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe inovative, përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe nxitjen e shkencës së hapur, aksesit të gjerë dhe bashkëpunimit në komunitetin akademik dhe kërkimor.

Fushat Prioritare

Kjo thirrje përfshin të gjitha fushat prioritare të kërkimit shkencor të miratuara në nivel kombëtar, në përputhje me prioritetet strategjike sektoriale të Qeverisë Shqiptare dhe me objektivat e Hapësirës Europiane të Kërkimit (ERA), përfshirë:

- Shkencat natyrore dhe inxhinierike
- Shkencat e jetës dhe shëndetit
- Bujqësinë dhe mjedisin
- Shkencat shoqërore dhe humane
- Teknologjinë, inovacionin dhe transformimin digjital

2. Thirrje për Projekt - Propozime në Kuadër të Programeve Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI)

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) shpall thirrjen për Propozime për “Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI) për vitin 2026”, me qëllim mbështetjen e kërkimit shkencor të aplikuar në fushat prioritare, përmes bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe aktorëve publikë e privatë, duke nxitur inovacionin dhe zhvillimin ekonomik e social.

Qëllimi i thirrjes

Thirrja është e hapur për aplikime për: Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI), që vijnë si bashkëpunim i IAL-ve me biznesin, industrinë, institucionet (qendrore e vendore). Qëllimi i thirrjes është mbështetja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushat prioritare, që synojnë përmirësimin e produkteve, shërbimeve, proceseve, në industri, bujqësi, shërbime, institucione etj.

Fushat Prioritare

Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe shkencat mjekësore
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

Thirrjet, manualin e aplikimit, anekset dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin zyrtar të Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI):
(<http://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare-2/>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj

